

**LIGJI NR. 06/L-111****PËR PAGAT NË SEKTORIN PUBLIK**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës,**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR PAGAT NË SEKTORIN PUBLIK****KAPITULLI I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****Neni 1  
Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Ky ligj përcakton:

- 1.1. sistemin e pagave dhe shpërblimeve për zyrtarët dhe funksionarët publikë, që paguhet nga buxheti i shtetit, përjashtimisht AKI dhe FSK;
- 1.2. rregullat për përcaktimin e pagave të punonjësve të ndërmarrjeve publike në Kosovë dhe
- 1.3. Kriteret për pagën kalimtare dhe përfitimet tjera pas përfundimit të funksionit për funksionarin publik dhe funksionarin publik me status të veçantë, si dhe për ish zyrtarin e lartë që është duke i realizuar të drejtat sipas ligjit përkatës.

**Neni 2  
Përkufizime**

1. Në këtë ligj shprehjet/fjalët kanë këtë kuptim:

- 1.1. **Paga bazë**, është komponenti kryesor apo i vetëm i pagës, që shpërblen punën sipas nivelit të kompleksit të funksionit, pozitës apo gradës dhe nivelit të kualifikimit të kërkuar për atë funksion, pozitë apo gradë. Kompleksi është pasojë e kombinuar e përgjegjësisë, rëndësisë dhe lirisë të vendimmarrjes, vështirësisë dhe rrezikshmërisë të kryerjes të detyrave në atë funksion, pozitë apo gradë, si dhe kufizimeve që shoqërojnë punën;
- 1.2. **Shtesë page**, është komponent i pagës, që i shtohet pagës bazë dhe që synon të shpërblejë punën për kushte të vështira, sektorë apo specialitete të veçanta dhe që nuk shpërblehet nga paga bazë. Shtesa e pagës mund të jetë e rregullt, kur përfitohet çdo muaj, apo e parregullt, kur shpërblehet sipas rastit dhe sipas këtij ligji;
- 1.3. **Shtesë e rregullt**, është shtesa për kushte tregu, shtesa e posaçme, shtesa e performancës në sistemin e arsimit parauniversitar dhe shtesa për kushte të vështira/të dëmshme të punës;
- 1.4. **“Shtesë e parregullt”**, është shtesa për punë jashtë orarit të punës dhe shtesa e performancës;

1.5. **“Shpërblim”**, është pagesa që shpërblen punën e kryer nga anëtari i një organi kolegjal me kohë jo të plotë;

1.6. **“Kompensim”**, është një pagesë në formën e heqjes së shpenzimeve të kryera apo që do të kryhen nga zyrtari, për udhëtime, qëndrim apo përfaqësim (reprezentacion) në apo gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare;

1.7. **“Klasa e pagës”**, është një ndarje që i korrespondon një koeficient i caktuar dhe që përbëhet nga një grup funksionesh, pozitash apo gradash me nivel të njëjtë apo pothuajse të njëjtë kompleksiteti dhe që përfitojnë të njëjtën pagë bazë.

2. Shprehjet: “funksionar publik”, “funksionar publik me status të veçantë”, “zyrtar publik”, “nëpunës civil”, “nëpunës civil me status të veçantë”, “nëpunës i Shërbimit Publik”, “nëpunës kabinetit”, “nëpunës administrativ dhe mbështetës”, në këtë ligj kanë të njëjtin kuptim me atë të përcaktuara në Ligjin për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës.

### Neni 3

#### Parimet e sistemit të pagave dhe shpërblimeve

1. Pagat bazohen sipas parimeve të përcaktuara me këtë ligj, si vijon:

1.1. parimi i ligjshmërisë - nënkupton që pagat e përfituesve përcaktohen vetëm në pajtim me këtë ligj dhe me aktet nënligjore, të autorizuar dhe të nxjerra në zbatim të tij;

1.2. parimi i drejtësisë – nënkupton që niveli i pagës duhet të shpërblejë në mënyrë të drejtë kompleksin e punës dhe kontributin e individit në punën e organizatës;

1.3. parimi i pagës së barabartë - nënkupton që secili përfitues i pagës merr pagë të barabartë për punën në funksionin, pozitën apo gradën e njëjtë apo të krahasueshme;

1.4. parimi i transparencës – nënkupton që procedura për përcaktimin e pagës, niveli i saj dhe administrimi i sistemit të pagave të jetë transparente për publikun, pa rënë në kundërshtim me mbrojtjen e të dhënave personale sipas legjislacionit në fuqi;

1.5. parimi i mosdiskriminimit - nënkupton që asnjë përfitues i pagës nuk diskriminohet në pagë, ashtu siç përcaktohet në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi;

1.6. parimi i parashikueshmërisë – niveli i pagës, i përcaktuar sipas këtij ligji, nuk mund të ulet, përveç në një situatë të jashtëzakonshme të vështirësive financiare dhe vetëm në bazë të ligjit.

## KAPITULLI II

### PAGA E NËPUNËSIT CIVIL

#### Neni 4

#### Paga e nëpunësit civil

1. Paga e nëpunësit civil përbëhet nga paga bazë dhe shtesat, sipas rastit.

2. Shtesat që përfitohen nga nëpunësi civil sipas rastit, janë:

2.1. shtesa për kushte tregu;

2.2. shtesa e performancës;

2.3. shtesa të posaçme për pozita apo grup pozitash sipas nenit 8 të këtij ligji;

2.4. shtesa për punë jashtë orarit të punës.

3. Paga e nëpunësit të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës rregullohet me këtë ligj, sipas shtojcës 1 të këtij ligji.

4. Shtesa dhe Kompensimi i nëpunësit të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

5. Rregullimi me akt të veçantë sipas paragrafit 4. të këtij neni, bëhet duke u bazuar në natyrën dhe kushtet specifike të punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

### **Neni 5 Paga bazë e nëpunësit civil**

1. Paga bazë e nëpunësit civil është ajo pjesë e pagës, që përfiton nëpunësi civil për punën e kryer në një pozitë të caktuar apo për një gradë të caktuar.

2. Paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet nga Klasa e Pagës të cilës i përket pozita e punës sipas Shtojcës nr. 1, bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse e këtij ligji.

3. Klasifikimi i një pozitë të caktuar të Shërbimit Civil, sipas paragrafit 2. të këtij neni, kryhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të Shërbimit Civil, në pajtim me legjislacionin për zyrtarin publik. Klasa që i përket një pozitë e caktuar përcaktohet shprehimisht në rregulloren e organizimit të brendshëm të institucionit, të miratuar sipas Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura.

4. Në rastin e nëpunësve civilë me status të veçantë, për të cilët sipas Ligjit për Zyrtarët Publik zbatohet sistemi i gradave personale, paga bazë përcaktohet nga Klasa e Pagës të cilës i përket grada, sipas Shtojcës nr. 1, bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse e këtij ligji.

5. Në rastin e nëpunësve civilë me status të veçantë, sipas paragrafit 4. të këtij neni, Qeveria e Kosovës, me propozim të ministrit përgjegjës për administratën publike dhe ministrit përgjegjës për kategoritë e nëpunësve ku zbatohet sistemi i gradave personale miraton, me akt nënligjor, ekuivalencën e pozitës me gradën.

### **Neni 6 Shtesa për kushte tregu**

1. Shtesa për kushte tregu përfitohet për profesione të caktuara- të nevojshme, në pozita të caktuara kyçe profesionale të Shërbimit Civil, rekrutimi apo mbajtja e nëpunësve në këto profesione e pozita objektivisht është i pamundur për shkak se tregu privat ofron paga të paktën pesëdhjetë për qind (50%) më të larta se sektori publik.

2. Vlera e shtesës për kushte tregu nuk mund të jetë më e lartë se pesëdhjetë për qind (50%) e pagës bazë.

3. Llojet e pozitave dhe profesionet përkatëse për të cilat përfitohet shtesa për kushtet e tregut, vlera dhe procedura për përfitimin e saj miratohet me akt nënligjor të Qeverisë së Kosovës, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa. Përfitimi i shtesës për kushtet e tregut rishikohet në baza vjetore nga Qeveria.

4. Pas miratimit të aktit nënligjor nga Qeveria, sipas paragrafit 3. të këtij neni, përfitimi i shtesës

për kushte tregu miratohet nga ministria përgjegjëse për administratën publike dhe ministria përgjegjëse për financa, me propozim të arsyetuar të institucionit përkatës.

### **Neni 7** **Shtesa e performancës**

1. Nëpunësi civil përfiton shtesë vjetore për performancë bazuar në rezultatet vjetore të vlerësimit të punës.
2. Shtesa për performancë përfiton nëpunësi civil që është vlerësuar "Shkëlqyeshëm" në vitin përkatës, në përpjesëtim të drejtë, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publik në lidhje me nëpunësin civil duke krahasuar me performancën e përgjithshme të institucionit.
3. Shtesa për performancë përfitohet në fund të çdo viti, totali i vlerës nuk mund të kalojë pesëdhjetë për qind (50%) të pagës bazë mujore.
4. Fondet e përdorura në çdo institucion për shtesën e performancës nuk mund të jenë më të larta se zero pikë pesë për qind (0.5 %) e fondeve totale të përdorura për pagën bazë të nëpunësve civilë në të njëjtin vit financiar.
5. Qeveria e Kosovës, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa, miraton, me akt nënligjor, masën dhe procedurën për fitimin e shtesës për performancë.

### **Neni 8** **Shtesa të posaçme të nëpunësve civilë**

1. Përfitojnë shtesë të posaçme mbi pagën bazë:
  - 1.1. zyrtarët e Administratës Tatimore dhe inspektorët hetues të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës;
  - 1.2. gardianët në shërbimin korrektues;
  - 1.3. zjarrfikësit në operacione të rrezikshme.
2. Shtesa e posaçme, sipas paragrafit 1. të këtij neni, nuk mund të jetë më e lartë se dyzet për qind (40%) e pagës bazë, sipas Shtojcës 1 të këtij ligji.
3. Lista e pozitive apo grup pozitive, që përfitojnë shtesën e posaçme, rregullat për përfitimin dhe vlera e shtesës përcaktohet me akt nënligjor të Qeverisë, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa.
4. Nëpunësit civilë në Agjencinë Kundër Korrupsionit, të cilët ushtrojnë funksione të Agjencisë, përfitojnë shtesë deri në njëzet për qind (20%) mbi pagën bazë.

### **Neni 9** **Shtesa apo kompensimi për punë jashtë orarit të punës**

1. Nëpunësi civil përfiton shtesë page ose kompensim me pushim për punën jashtë orarit të punës, kujdestarisë, punën në fundjavë, punën në ditët e festave zyrtare dhe për punën gjatë natës.
2. Puna jashtë orarit të punës kompensohet në masën pesëdhjetë për qind (50%) me kohë pushimi dhe në masën pesëdhjetë për qind (50%) me shtesë page.

3. Më kërkesë të nëpunësit, mund të përfitojë kompensim me kohë pushimi mbi masën pesëdhjetë për qind (50%).
4. Shtesa e pagës apo kompensimi me kohë pushimi, për punë jashtë orarit të punës llogaritet në pajtim me dispozitat e Ligjit të Punës.
5. Qeveria miraton, me akt nënligjor, kushtet e detajuara për shtesa dhe kompensime për punë jashtë orarit të punës sipas këtij neni.

### **KAPITULLI III PAGAT E FUNKSIONARËVE PUBLIKË**

#### **Neni 10 Paga e funksionarit publik**

1. Funksionari publik përfiton një pagë fikse të barabartë me pagën bazë për funksionin.
2. Paga bazë për funksionarin publik përcaktohet nga Klasa e Pagës të cilës i përket funksioni në pajtim me Shtojcën nr. 1 të këtij ligji, bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse e këtij ligji.
3. Funksionari publik nuk përfiton shtesa të tjera mbi pagën bazë, me përjashtim të shtesës së posaçme të përcaktuar në pajtim me nenin 12 të këtij ligji.

#### **Neni 11 Shpërblimi i funksionarëve për kohë të pjeshme**

1. Anëtarët e organeve drejtuese (këshilla, borde, komisione), të tipit kolegjal, të institucioneve kushtetuese, të agjencive të pavarura dhe të institucioneve të sistemit të drejtësisë, të krijuara me ligj, të cilët nuk e ushtrojnë mandatin me kohë të plotë dhe nuk përmenden shprehimisht në Shtojcën nr.1 të këtij ligji, shpërblehen në masën njëzet për qind (20 %) të pagës së kryetarit të organit kolegjal me kohë të plotë.
2. Në rastin kur edhe kryetari i organit drejtues është me kohë të pjeshme, atëherë shpërblimi i tij, si dhe shpërblimi i anëtarëve të organit drejtues, bëhet në masën tridhjetë për qind (30%) për kryetarin dhe njëzet për qind (20%) për anëtarët, të pagës së Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit.
3. Shpërblimi i parashikuar në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni përfitohet çdo muaj, me kusht pjesëmarrje në mbledhjet e organit kolegjal, jo më pak se një herë në muaj dhe për çdo mbledhje të organit kolegjal, me kusht pjesëmarrje në mbledhje, në rastin kur ky organ mbledhet më rrallë se një herë në muaj.
4. Kryetarët, anëtarët dhe punonjësit e tjerë të institucionit, në marrëdhënie pune me kohë të plotë, nuk përfitojnë shpërblimin e parashikuar në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni, për pjesëmarrje në mbledhjet e organit kolegjal.

#### **Neni 12 Shtesa të posaçme për funksionarët publik**

1. Deputetët mund të përfitojnë shtesë të posaçme mbi pagën bazë.
2. Shtesa e posaçme, nga paragrafi 1. i këtij neni, i takon deputetit për funksion parlamentar: Kryetar i Kuvendit, nënkryetar i Kuvendit, kryetar i komisionit parlamentar, zëvendëskryetar i komisionit parlamentar dhe kryetar i grupit parlamentar.

3. Deputeti ka të drejtë në kompensim për pjesëmarrje në seancë plenare, për pjesëmarrje në mbledhje të komisionit parlamentar dhe për shpenzimet mujore.
4. Kriteret dhe procedurat për shtesa dhe kompensim nga paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni, me propozim të Komisionit përkatës parlamentar për buxhet dhe financa, përcaktohen me rregullore nga Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës.
5. Shtesa nga paragrafi 2. i këtij neni paguhet vetëm për një funksion dhe nuk mund të kalojë tridhjetë për qind (30 %) të pagës bazë.
6. Shtesa dhe kompensimi për stafin politik të Kuvendit të Republikës së Kosovës rregullohet me akt të veçantë të miratuar nga Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës.
7. Anëtarët e Kuvendit Komunal për pjesëmarrje në mbledhjet e Kuvendit Komunal dhe komitetet e përhershme, mund të marrin një shtesë të posaçme prej tridhjetë për qind (30%) të pagës bazë të përcaktuar për anëtarin e Kuvendit.
8. Anëtarët e Kuvendit Komunal, që marrin një pagë të rregullt nga buxheti i Kosovës, përfitojnë vetëm shtesën sipas paragrafit 7. të këtij neni.
9. Shtesa jepet vetëm një (1) herë brenda muajit dhe paguhet vetëm nëse anëtarët e Kuvendit Komunal marrin pjesë në mbledhjet e Kuvendit Komunal, përkatësisht të komiteteve të përhershme komunale.

#### **KAPITULLI IV PAGAT E FUNKSIONARËVE PUBLIKË ME STATUS TË VEÇANTË**

##### **Neni 13 Paga e funksionarit publik me status të veçantë**

1. Funksionari publik me status të veçantë përfiton një pagë fikse të barabartë me pagën bazë për funksionin apo gradën përkatëse.
2. Paga bazë për funksionarin përcaktohet nga Klasa e Pagës të cilës i përket funksioni apo grada, në pajtim me Shtojcën nr. 1, bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse e këtij ligji.
3. Funksionari me status të veçantë nuk përfiton shtesa të tjera mbi pagën bazë, me përjashtim të nenit 14 të këtij ligji.

##### **Neni 14 Shtesa të posaçme për Funksionarin publik me status të veçantë**

1. Zyrtarët policor përfitojnë një shtesë të posaçme për ato detyra që kryejnë në sektorë apo operacione të posaçme me rrezikshmëri për jetën.
2. Shtesa e posaçme, sipas paragrafit 1. të këtij neni, nuk mund të jetë më e lartë se dyzet për qind (40%) e pagës bazë, sipas Shtojcës 1 të këtij ligji.
3. Inspektorati policor, zyrtarët doganor dhe zyrtarët e Administratës Tatimore përfitojnë shtesë deri në njëzet për qind (20%) të pagës bazë.
4. Lista e pozitave të zyrtarëve policor, Inspektoratit policor, zyrtarëve doganor dhe zyrtarëve të Administratës Tatimore, që përfitojnë shtesën e posaçme, rregullat për fitimin dhe vlera e shtesës përcaktohet me akt nënligjor të Qeverisë, me propozim të ministrisë përgjegjëse për punë të brendshme dhe ministrisë përgjegjëse për financa.

## **KAPITULLI V PAGA E NËPUNËSIT TË KABINETIT**

### **Neni 15 Paga e nëpunësit të Kabinetit**

1. Nëpunësi i kabinetit përfiton një pagë fikse të barabartë me pagën bazë.
2. Për çdo emërtesë të nëpunësit të kabinetit përcaktohet klasa e pagës të cilës i përket emërtesa, në pajtim me Shtojcën nr.1 bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse e këtij ligji.
3. Përveç pagës bazë, nëpunësi i Kabinetit, me përjashtim të këshilltarit politik, mund të përfitojë një shtesë të posaçme, e cila nuk mund të kalojë njëzet për qind (20%) të pagës bazë.
4. Kriteret dhe procedura për përfitimin e shtesës, sipas paragrafit 3. të këtij neni, rregullohen me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria.

## **KAPITULLI VI PAGA E NËPUNËSIT TË SHËRBIMIT PUBLIK DHE E NËPUNËSIT ADMINISTRATIV DHE MBËSHTETËS**

### **Neni 16 Struktura e pagës për nëpunësin e Shërbimit Publik dhe nëpunësin administrativ dhe mbështetës**

1. Paga e nëpunësit të Shërbimit Publik dhe nëpunësit administrativ dhe mbështetës përbëhet nga paga bazë dhe shtesat.
2. Shtesat që përfitohen nga nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës, sipas rastit, janë:
  - 2.1. shtesa për kushte të vështira/të dëmshme të punës;
  - 2.2. shtesa e performancës për nëpunësin e sistemit të arsimit parauniversitar;
  - 2.3. shtesa të posaçme për pozita apo grup pozitash sipas neneve 19 dhe 20 të këtij ligji;
  - 2.4. shtesa për punë jashtë orarit të punës.
3. Paga bazë për nëpunësit e Shërbimit Publik dhe nëpunësin administrativ dhe mbështetës përcaktohet nga Klasa e Pagës të cilës i përket pozita në pajtim me Shtojcën nr. 1, bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse e këtij ligji.
4. Për shtesën për punën jashtë orarit të punës zbatohen dispozitat e nenit 9 të këtij ligji.

### **Neni 17 Shtesa për kushte të vështira/të dëmshme të punës**

1. Shtesa për kushte të vështira/të dëmshme shpërblen punën në kushte të dëmshme për shëndetin.
2. Kriteret, të cilat duhen përmbushur për përfitimin e shtesës për kushte të vështira/dëmshme të punës, janë:

2.1. kryerja normale e punës përfshin rrezikun e shkakimit të plagëve, sëmundje ose probleme shëndetësore të menjëhershme apo të mëvonshme, si pasojë e ekspozimit në ambientin e punës ku paraqiten elemente të dëmshme kimike, fizike, biologjike, psikologjike, si dhe dëmtime nga përdorimi i mjeteve të punës; dhe

2.2. rreziku për shëndetin është i vazhdueshëm, i mundshëm dhe serioz, me gjithë faktin se institucioni ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për përmirësimin e gjendjes në vazhdimësi.

3. Shtesa për kushte të vështira/të dëmshme nuk mund të jetë më e lartë se dhjetë për qind (10%) e pagës bazë.

4. Qeveria e Republikës të Kosovës, me propozimin e ministrit përgjegjës për administratën publike, ministrisë përgjegjëse për shëndetësi dhe ministrisë përgjegjëse për financa, miraton, me akt nënligjor, grup pozitave të cilat përfitojnë shtesa për kushte të vështira/të dëmshme të punës, kushtet e detajuara për përfitimin dhe vlerën e saj.

#### **Neni 18**

##### **Shtesa e performancës për nëpunësin e sistemit të arsimit parauniversitar**

1. Nëpunësit profesionalë të sistemit të arsimit parauniversitar, të cilët tregojnë rezultate të veçanta në punë, kanë të drejtë të marrin shtesën e performancës.

2. Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozimin e ministrit përgjegjës për administratën publike, ministrisë përgjegjëse për arsim dhe ministrisë përgjegjëse për financa, miraton, me akt nënligjor, rregullat për shtesën sipas paragrafit 1. të këtij neni, kushtet e detajuara për përfitimin dhe masën e saj.

#### **Neni 19**

##### **Shtesa e posaçme për nëpunësin e arsimit universitar**

1. Profesorët universitarë, që kryejnë funksionet, si: rektori, prorektori, dekani dhe prodekani dhe shefi i departamentit, përfitojnë një shtesë të posaçme për ushtrimin e funksionit përkatës. Vlera e shtesës nuk mund të kalojë njëzet për qind (20%) të pagës bazë.

2. Profesorët universitarë gjithashtu për kryerjen e punës si mentorë të temave të diplomës për të gjitha nivelet e studimeve (baçelor, master dhe doktoratë), mund të përfitojnë një shtesë të posaçme, dhjetë për qind (10%) të pagës bazë.

3. Personeli akademik në arsimin universitar i cili ofron shërbime shëndetësore në SHSKUK, kur këtë e lejon ligji, përfiton një shtesë në vlerë prej tridhjetë për qind (30%) të pagës për pozitën me orar të plotë të punës ku ofrohet shërbimi përkatës publik nga punëdhënësi i cili është përgjegjës për ofrimin e atij shërbimi.

4. Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratën publike, ministrisë përgjegjëse për arsim dhe ministrisë përgjegjëse për financa miraton, me akt nënligjor, rregullat për shtesën sipas paragrafëve 1. dhe 2. të këtij neni, kushtet e detajuara për përfitimin dhe vlerën e shtesave.

#### **Neni 20**

##### **Shtesa e posaçme për nëpunësin e sistemit shëndetësor**

1. Profesionistët shëndetësor në SHSKUK dhe QKMF, që ushtrojnë funksione udhëheqëse dhe të cilat nuk janë pjesë e shtojcës 1. të këtij ligji përfitojnë një shtesë të posaçme për ushtrimin e funksionit përkatës.



2. NËpunësi profesional i sistemit shëndetësor, i cili ushtron detyrën si personel akademik në arsimin universitar kur këtë e lejon ligji, përfiton një shtesë në vlerë prej tridhjetë për qind (30%) të pagës për pozitën me orar të plotë të punës ku ofrohet shërbimi përkatës publik nga punëdhënësi i cili është përgjegjës për ofrimin e atij shërbimi.

3. NËpunësit profesionalë të sistemit shëndetësorë, të cilët ushtrojnë detyrën në profesione të veçanta, të rralla apo në lokacione të largëta, përfitojnë një shtesë të posaçme.

4. Shtesa e posaçme, sipas paragrafëve 1. dhe 3. të këtij neni, nuk mund të jetë më e madhe se njëzet për qind (20%) e pagës bazë.

5. Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozimin e ministrit përgjegjës për administratën publike, ministrisë përgjegjëse për shëndetësi dhe ministrisë përgjegjëse për financa, miraton, me akt nënligjor, grup pozitave, rregullat për shtesën sipas këtij neni, kushtet e detajuara për përfitimin dhe masën e saj.

## **KAPITULLI VII LLOGARITJA DHE REALIZIMI I PAGËS**

### **Neni 21 Llogaritja e pagës bazë**

1. Paga bazë është ajo pjesë e pagës, që përfitohet për punën e kryer me orar të plotë në një funksion apo pozitë të caktuar.

2. Punë me orar të plotë konsiderohet puna me kohëzgjatje javore prej dyzet (40) orësh. Për efekt të llogaritjes të pagës mujore, një (1) muaj llogaritet të ketë njëqind e shtatëdhjetë e tri (173) orë pune.

3. Vlera e pagës bazë, për punën e kryer me orar të plotë, llogaritet duke shumëzuar koeficientin e klasës së pagës me vlerën monetare të koeficientit.

4. Raporti i koeficienteve është një me dhjetë (1:10), të shpërndarë në gjashtëdhjetë e nëntë (69) nivele të koeficienteve, bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse si Shtojca 2 e këtij ligji.

5. Funksonari publik, funksionari publik me status të veçantë, zyrtari publik dhe stafi akademik universitar, që marrin pagën bazë sipas Shtojcës 1 të këtij ligji, nëse angazhohen me punë në një institucion tjetër publik, kur këtë e lejon ligji i veçantë, marrin një pagesë, si pagë deri në njëzet për qind (20%) për angazhimin në atë institucion.

6. Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa, miraton, me akt nënligjor, kushtet, masën dhe procedurën e pagesës për angazhimin shtesë sipas paragrafit 5. të këtij neni.

7. Paga bazë rritet në bazë të përvojës së punës në masën zero pikë pesë për qind (0.5%) për çdo vit të plotë pune.

8. Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa, miraton me akt nënligjor, rregullat për llogaritjen e përvojës në punë, sipas paragrafit 7. të këtij neni.

### **Neni 22 Llogaritja dhe pagesa**

1. Paga (paga bazë dhe shtesat) llogaritet çdo muaj nga institucioni përkatës, në raport me kohën efektive të punës dhe rregullat e këtij ligji.

2. Paga do të paguhet për çdo muaj.
3. Paga paguhet nëpërmjet listës së pagave dhe transferimit të mjeteve në llogaritë personale/individuale bankare deri në datën e fundit të muajit përkatës.
4. Pagesat e pagave bëhen përmes sistemit të pagave, të menaxhuar nga Ministria e Financave, i cili ndërvepron me sistemin informativ të burimeve njerëzore.
5. Qeveria e Republikës së Kosovës, me akt nënligjor, me propozim të ministrit përgjegjës për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa, miraton rregullat e detajuara për zbatimin e këtij neni.

### **Neni 23**

#### **Përcaktimi i vlerës së koeficientit dhe fondi për shtesa**

1. Vlera monetare e koeficientit për vitin e parë të zbatimit të këtij ligji do të jetë dyqind e tridhjetë e nëntë (239) euro.
2. Për vitet e tjera buxhetore, vlera monetare e koeficientit përcaktohet me ligjin vjetor të buxhetit.
3. Përcaktimi i vlerës së koeficientit bëhet në pajtim me legjislacionin për menaxhimin e financave publike.
4. Fondi i përgjithshëm për të gjitha shtesat sipas këtij ligji nuk mund të kalojë tetë për qind (8%) të buxhetit të përgjithshëm të pagës bazë të përcaktuar sipas ligjit për ndarjet buxhetore.
5. Fondi sipas paragrafit 4. të këtij neni alokohet nga ministria përgjegjëse e financave për organizatat buxhetore vetëm në pajtim me këtë ligj dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji.

### **Neni 24**

#### **Ulja e nivelit të pagës**

Niveli i pagës, i përcaktuar sipas këtij ligji, në situata të jashtëzakonshme të vështirësive financiare, mund të ulet me ligj.

## **KAPITULLI VIII KOMPENSIMET**

### **Neni 25**

#### **Kompensimi për udhëtime dhe shpenzimet e reprezentacionit**

1. Zyrtarët dhe funksionarët publikë kanë të drejtë të kompensohen për shpenzimet e kryera për udhëtime dhe qëndrim zyrtar jashtë vendit.
2. Zyrtarët dhe funksionarët publik gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, kanë të drejtë për shpenzimet e kryera për reprezentacion.
3. Kushtet, mënyra, vlera e kompensimit dhe procedura për përfitimin e kompensimit, sipas paragrafëve 1. dhe 2. të këtij neni, miratohen me akt nënligjor të Qeverisë së Kosovës, me propozim të ministrit përgjegjës për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa.

### **Neni 26**

#### **Kompensimi për punonjësit e shërbimit diplomatik, të cilët ushtrojnë detyrën jashtë vendit**

1. Punonjësit e shërbimit diplomatik, që ushtrojnë detyrën jashtë vendit, përfitojnë këto

kompensime:

- 1.1. kompensim për koston e jetesës sipas vendit ku ushtrohet veprimtaria;
- 1.2. kompensim për shpenzimet e shkollimit të fëmijëve;
- 1.3. kompensim për zhvendosje të sendeve familjare;
- 1.4. kompensim për udhëtime në atdhe.

2. Kushtet, mënyra dhe procedura për përfitimin e kompensimit sipas paragrafit 1. të këtij neni dhe vlera përkatëse miratohet me akt nënligjor të Qeverisë, me propozim të ministrit përgjegjës për punët e jashtme dhe Ministrisë së Financave.

## **KAPITULLI IX DISPOZITA PËR PAGAT E NDËRMARRJEVE PUBLIKE**

### **Neni 27**

#### **Kompetenca për caktimin e pagave në ndërmarrjet publike**

1. Organet kolegjiale drejtuese të ndërmarrjeve publike, me kapital mbi pesëdhjetë për qind (50%) shtetëror, miratojnë:

- 1.1. nivelet e pagave të punonjësve të tyre të caktuar nga Qeveria, brenda koeficientit minimal 1 dhe koeficienti maksimal 7, sipas vlerës së koeficientit të përcaktuar me nenin 23 paragrafi 1. të këtij ligji;
- 1.2. masën e shtesës për performancë, por jo më shumë se një pagë mujore në vit, pas daljes së rezultatit pozitiv financiar vjetor, si dhe pas miratimit nga Komisioni ndërministror për ndërmarrje publike.

2. Për ndërmarrjet publike, veprimtaria e të cilave është me humbje, ose që subvencionohen nga shteti, Qeveria e Kosovës, me propozim të Komisionit ndërministror për ndërmarrje publike, miraton, me akte të veçanta, nivelin e pagave dhe të shtesave për performancën e punonjësve të tyre sipas paragrafit 1. nën-paragrafit 1.1. të këtij neni.

3. Komisioni Komunal i Aksionarëve, për ndërmarrjet publike, me kapital mbi pesëdhjetë për qind (50%) të zotëruar nga komunat, cakton nivelet e pagave të punonjësve të tyre, brenda koeficientit minimal 1 dhe koeficientit maksimal 5, sipas vlerës së koeficientit të përcaktuar me nenin 23 paragrafin.1. të këtij ligji.

## **KAPITULLI X DISPOZITA TRANZITORE DHE TË FUNDIT**

### **Neni 28**

#### **Dispozita tranzitore**

1. Dispozitat e këtij ligji për sistemin e pagave, shtesave, shpërblimeve dhe shtojca nr. 1 e këtij ligji nuk zbatohen për funksionarin publik me status të veçantë: gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarin, prokurorin, kryesuesin e Këshillit Gjyqësor dhe kryesuesin e Këshillit Prokurorial deri me 31 dhjetor 2022.

2. Funksionari publik nga paragrafi 1. i këtij neni nuk do të përfitojë asnjë shtesë tjetër mbi pagë dhe asnjë rritje page për periudhën e përcaktuar në paragrafin 1. të këtij neni.

## Neni 29

Për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, dispozitat e këtij ligji për sistemin e pagave, shtesave, shpërblimeve dhe shtojca numër 1 e këtij ligji nuk zbatohet deri me 31 dhjetor 2022.

## Neni 30

### Pagesa kalimtare pas përfundimit të funksionit

1. Funksionari publik dhe funksionari publik me status të veçantë: Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Kryeprokurori i Shtetit, Kryetari i Gjykatës Supreme, i cili pas përfundimit të mandatit nuk realizon asnjë të hyrë nga buxheti i shtetit, nga institucioni ku ka bartur funksionin, ka të drejtë në:

1.1. kompensimin kalimtar për pesë (5) vite në vlerë prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pagës bazë të fundit, në institucionin në të cilin ka bartur funksionin;

1.2. një asistent, një vozitës, të cilët zgjidhen nga funksionari dhe një veturë zyrtare në përdorim, të cilët paguhen në pajtim me ligjin përkatës për paga, dhe

1.3. një zyre të mobiluar.

2. E drejta e përcaktuar në paragrafin 1. të këtij neni zbatohet nëse funksionari publik ka ushtruar së paku një (1) vit mandatin e tij.

3. Deputeti pas përfundimit të mandatit të rregullt apo para kohe, i cili nuk realizon asnjë të hyrë nga buxheti i shtetit, ka të drejtë në kompensimin e pagës kalimtare për një (1) vit në vlerë prej njëqind për qind (100%) të pagës bazë të fundit.

4. Funksionari publik: Zëvendëskryeministri, Ministri dhe Kryetari i Komunës, i cili pas përfundimit të mandatit nuk realizon asnjë të hyrë nga buxheti i shtetit, ka të drejtën e kompensimit kalimtar për një (1) vit në vlerë prej shtatëdhjetë (70%) të pagës bazë të fundit, në institucionin në të cilin ka bartur funksionin.

5. Funksionari publik: Zëvendësministri, i cili pas përfundimit të mandatit nuk realizon asnjë të hyrë nga buxheti i shtetit, ka të drejtën e kompensimit kalimtar për gjashtë (6) muaj në vlerë prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pagës bazë të fundit, në institucionin në të cilin ka bartur funksionin.

6. E drejta në kompensim të pagës së përcaktuar në paragrafët 4. dhe 5. të këtij neni zbatohet vetëm nëse ka ushtruar së paku gjashtë (6) muaj mandatin e tij të rregullt.

7. Përftimi i paraparë sipas këtij neni nuk paguhet nëse funksionari:

7.1. jep dorëheqje nga funksioni;

7.2. shkarkohet nga funksioni për shkelje ligjore;

7.3. pas përfundimit të mandatit, ushtron ndonjë funksion për të cilin paguhet nga Buxheti i Republikës së Kosovës;

7.4. me vendim të formës së prerë nga gjykata është shpallur fajtor për një vepër penale të kryer gjatë kohës së tij/saj në Institucionin ku ka bartur funksionin, ose gjatë periudhës së marrjes së përfitimit të paraparë me këtë nen.

8. Funksionari, i përcaktuar në këtë nen, pas përfundimit të mandatit ka të drejtë të kërkojë mbrojtje në pajtim me ligjin.

9. Ish zyrtari i lartë që është duke i realizuar të drejtat sipas Ligjit nr. 03/L-001 për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-038, ka të drejtën e përfitimit deri në pesë (5) vite, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

### **Neni 31 Aktet nënligjore**

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj miratohen brenda nëntë (9) muajve pas publikimit në "Gazetën Zyrtare" të Republikës së Kosovës.

### **Neni 32 Ndalimi dhe përcaktimi i ekuivalencës**

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ndalohet çdo ndryshim në strukturën, komponentët apo nivelet e koeficienteve të pagave.

2. Me rastin e krijimit të funksioneve, pozitave, apo emërtesat e reja, institucioni në të cilin krijohet pozita kërkon nga ministria përgjegjëse për administratën publike dhe ministria përgjegjëse e financave përcaktimin e klasës të pagës që zbatohet për atë funksion, pozitë apo emërtesë në bazë të ekuivalencës.

3. Me marrjen e kërkesës, ministria përgjegjëse për administratën publike dhe ministria përgjegjëse e financave vlerësojnë funksionin, pozitën apo emërtesën me ekuivalencë në bazë të parimeve të këtij ligji dhe bëjnë propozimin për aprovim në Qeveri, për klasën e pagës që zbatohet për atë funksion, pozitë apo emërtesë.

### **Neni 33 Shfuqizimi**

1. Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji shfuqizohen:

1.1. Ligji nr. 03/L-147 për pagat e nëpunësve civil;

1.2. Ligji nr. 03/L-001 për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-038;

1.3. Neni 11, paragrafi 2. i ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës;

1.4. Neni 15 i Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;

1.5. Neni 9 i Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit;

1.6. Neni 35, paragrafët 1. dhe 2. të Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat;

1.7. Neni 21, paragrafi 1., nën-paragrafët 1.1. deri në 1.10., i Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit;

1.8. Neni 18, paragrafi 1., i Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe çdo dispozitë e ligjit dhe e aktit nënligjor që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave dhe shpërblimeve.

**Neni 34**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 9 (nëntë) muaj pas publikimit në "Gazetën Zyrtare" të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 06/L-111**  
**2 shkurt 2019**

**Ligji shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 80**  
**paragrafi 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.**

Shtojca nr. 1				
Nr.	Titulli i pozitës	Klasa	Koeficienti	Institucioni/Fusha e zbatimit
1	President i Kosovës	A1	10	
2	Kryetar i Kuvendit të Kosovës	A2	9	
3	Kryeministër i Kosovës			
4	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese			
5	Nënkryetar i Kuvendit	A3	8.5	
6	Zëvendëskryeministër			
7	Zëvendëskryetari i Gjykatës Kushtetuese			
8	Ministër	A4	8	
9	Kryetar i Kryeqytetit			
10	Deputeti			
11	Kryetar i Gjykatës Supreme			
12	Kryesues i Këshillit Gjyqësor			
13	Kryesues i Këshillit Prokurorial			
14	Kryeprokuror i Shtetit			
15	Drejtori i Përgjithshëm i Policisë			
16	Kryetar i Akademisë së Shkencave			
17	Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese			
18	Kryetar i Dhomës së Posaçme			
19	Avokat i Popullit			
20	Auditori i Përgjithshëm i Kosovës	A4	8	

21	Zëvendës kryeprokuror i Shtetit				
22	Gjyqtar i Gjykatës Supreme				
23	Shef i stafit			Presidencë, në Zyrën e Kryeministrit dhe në Gjykatën Kushtetuese	
24	Kryetar i Komunës				
25	Kryeprokuror i Prokurorisë Speciale	A5	7.75		
26	Prokuror në Prokurorinë e Shtetit/Speciale	A6	7.5		
27	Zëvendës kryesues i Këshillit Prokurorial/Gjyqësor				
28	Kryeprokuror i Prokurorisë së Apelit				
29	Drejtor i Përgjithshëm i Transmetuesit Publik - RTK				
30	Kryetar i Gjykatës së Apelit	A7	7		
31	Komisioner i Mbrojtjes së të Dhënave Personale				
32	Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit				
33	Zëvendës auditor i Përgjithshëm				
34	Kryetar i Gjykatës Themelore				
35	Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore				
36	Gjyqtar i Gjykatës së Apelit				
37	Prokuror në Prokurorinë e Apelit	A8	6.75		
38	Prokuror i Prokurorisë Themelore për Krime të Rënda				
39	Gjyqtar i Gjykatës Themelore për Krime të Rënda	A9	6.65		
40	Nënkryetar i Akademisë së Shkencave	A10	6.5		



41	Shef i Kabinetit			Presidencë, në Zyrën e Kryeministrit dhe në Gjykatën Kushtetuese	
42	Këshilltar i lartë politik 1				
43	Anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave	A11	6.25		
44	Gjyqtar mbikëqyrës në Degën e Gjykatës Themelore	A12	6.15		
45	Zëvendësministër				
46	Kryetari i Komisionit të Pavarur për Media				
47	Kryetar i Organit Kolegjial	A13	6	në institucione të pavarura kushtetuese dhe agjenci të pavarura që kanë organe kolegjiale dhe i përgjigjen Kuvendit të Kosovës.	
48	Ndihmës i Auditorit të Përgjithshëm				
49	Zëvendës avokat i popullit				
50	Drejtor i Përgjithshëm në Agjencitë Rregullatore	A14	5.7		
51	Anëtar me korrespondencë i Akademisë së Shkencave	A15	5.6		
52	Prokuror i Prokurorisë Themelore				
53	Gjyqtar i Gjykatës Themelore	A16	5.5		
54	Ambasador	A17	5.25	në diplomaci	

55	Anëtar i organeve kolegjiale			në institucione të pavarura kushtetuese dhe agjenci të pavarura që kanë organe kolegjiale dhe i përgjigjen Kuvendit të Kosovës.	
56	Anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve				
57	Zëvendës drejtor i përgjithshëm në Agjencitë Rregullatore				
58	Gjyqtar për Kundërvajtje				
59	Këshilltar politik 1			Presidencë dhe në Zyrën e Kryeministrit	
60	Këshilltar i lartë politik 2	A18	5	në ministri	
61	Shef i Protokollit	A19	4.7	Presidencë dhe në Zyrën e Kryeministrit	
62	Nënkryetar i komunës	A20	4.1		
63	Kryesues i Kuvendit Komunal	A21	4		
64	Këshilltar politik 2			në ministri dhe institucione kushtetuese	
65	Drejtor i Drejtorisë Komunale	A22	3.8		
66	Zëvendës kryesues i Kuvendit Komunal	A23	3		
67	Shef i Kabinetit të Kryetarit të Komunës	A24	2.5	në komuna	
68	Anëtar i Kuvendit Komunal	A25	1.7	në komuna	
69	Drejtues i Lartë 1			në Shërbimin Civil (Sekretari i Përgjithshëm në Presidencë, Zyrë të Kryeministrit dhe Gjykatë Kushtetuese)	
70	Drejtori i Përgjithshëm i Doganave	B1	7		
71	Zëvendës drejtor i Përgjithshëm i Doganave	B2	6.5		
72	Drejtor i Drejtorisë në Doganë	B3	6		

73	Drejtues i lartë 2	B4	5.8	Në Shërbimin Civil (Sekretari i Përgjithshëm në ministri; Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore; Drejtor i Përgjithshëm/Kryeshf ekzekutiv në agjenci dhe institucione të pavarura, ATK/Thesar)
74	Drejtues i lartë 3	B5	5.4	Në Shërbimin Civil dhe në Administratën e Shërbimeve Publike (Drejtor i Përgjithshëm në agjenci ekzekutive; Sekretar i Përgjithshëm në Universitet, Avokat i përgjithshëm shtetëror)
75	Drejtues i lartë 4	B6	4.5	Në Shërbimin Civil dhe në Administratën e Shërbimeve Publike (zëvendës drejtor i përgjithshëm në agjencitë ekzekutive të përcaktuara me ligje të themelimit - ATK, AVUK)
76	Drejtor i Instituteve Hulumtuese - Shkencore			
77	Udhëheqës i Departamentit në Doganë			
78	Udhëheqës i Degës Doganore	C1	5.2	
79	Drejtues i mesëm 1			C2
80	Drejtues i mesëm 2	C3	4	në Shërbimin Civil (Drejtor i Departamentit në Presidencë, Zyrë të Kryeministrit, ministri, institucione kushtetuese dhe të pavarura, agjenci të pavarura, polici dhe drejtor i burgjeve)

81	Drejtues i mesëm 3			Në Shërbimin Civil dhe në Administratën e Shërbimeve Publike (Drejtor i Departamentit në agjenci ekzekutive, drejtor i departamenteve të administratave të shërbimeve publike, zëvendësdrejtor i burgjeve)	
82	Udhëheqës njësie/ Ndërrimi Doganë	C4	3.65		
83	Drejtues i ulët 1	C5	3.2	në Shërbimin Civil dhe në Administratën e Shërbimeve Publike (udhëheqës i Divizionit në Presidencë, Zyrë të Kryeministrit, ministri, institucione kushtetuese dhe të pavarura dhe agjenci të pavarura)	
84	Drejtues i ulët 2			në Shërbimin Civil dhe në Administratën e Shërbimeve Publike (udhëheqës i Divizionit në agjenci ekzekutive, udhëheqës i sektorit në komuna)	
85	Komandant i zjarrfikësve	C6	2.8		
86	Shef sektori/Njësisë	C7	2.3	ATK	
87	Kryepunëtor	C8	2.2		
88	Udhëheqës i stafit administrativ teknik	C9	2		
89	Ministër këshilltar diplomatik/Ministër fuqplotë	D1	3.7	në diplomaci	
90	Këshilltar diplomatik	D2	3	në diplomaci	
91	Zyrtar i lartë doganor	D3	3.1		
92	Ekzekutiv profesional 1	D4	2.9	pozitat profesionale të veçanta në administratën shtetërore dhe në agjenci të pavarura (ekspert në prokurori të shtetit, ekspert në agjenci të pavarura rregullatore, ekspert në forenzikë, specialist buxheti dhe specialist makroekonomik në Ministrinë e Financave, ekspert që administrojnë sisteme qendrore të TIK-ut, Inspektor i Arsimit në MASHT )	

93	Ekzekutiv profesional 2			pozitat profesionale të veçanta në administratën shtetërore dhe në agjenci të pavarura (ekspert në prokurori të shtetit, ekspert në agjenci të pavarura rregullatore, ekspert në forenzikë, specialist buxheti dhe specialist makroekonomik në Ministrinë e Financave, në Shërbimin Korrektues, ekspert që administrojnë sisteme qendrore të TIK-ut)	
94	Konsull			në diplomaci	
95	Sekretar i parë i ambasadës	D5	2.65	në diplomaci	
96	Zëvendës konsull			në diplomaci	
97	Zyrtar doganor				
98	Sekretar i dytë i ambasadës	D6	2.6	në diplomaci	
99	Instruktur në qendrat e kompetencës /profesionale	D7	2.4		
100	Ekzekutiv profesional 3			pozitat profesionale në Shërbimin Civil dhe pozitat profesionale të nëpunësve të shërbimeve publike (niveli qendror dhe lokal)	
101	Sekretar i tretë i ambasadës			në diplomaci	
102	Atashe në ambasadë	D8	2.35	në diplomaci	
103	Zjarrfikës	D9	2.2		
104	Zyrtar i ri doganor	D10	2		
105	Ekzekutiv profesional 4	D11	2.15	pozitat profesionale në Shërbimin Civil dhe pozitat profesionale të nëpunësve të shërbimeve publike (niveli qendror dhe lokal)	

106	Ekzekutiv profesional 5	D12	1.85	pozitat profesionale në Shërbimin Civil dhe pozitat profesionale të nëpunësve të shërbimeve publike (niveli qendror dhe lokal)	
107	Ekzekutiv profesional 6	D13	1.65	pozitat profesionale në Shërbimin Civil dhe pozitat profesionale të nëpunësve të shërbimeve publike (niveli qendror dhe lokal)	
108	Kadet doganor	D14	1		
109	Shef i stafit (KK)	E1	7.75	Kuvendi	
110	Zëvendës shef i Stafit	E2	6.5	Kuvendi	
111	Këshilltar i Kryetarit/Nënkryetarit	E3	6	Kuvendi	
112	Zyrtar i lartë personal i Kryetarit	E4	4.1	Kuvendi	
113	Zyrtar personal i Kryetarit	E5	3.7	Kuvendi	
114	Këshilltar i Grupit Parlamentar	E6	3.7	Kuvendi	
115	Zyrtar për Siguri – Truproje/Media	E7	3.7	Kuvendi	
116	Menaxher i zyrës së Kryetarit	E8	3.7	Kuvendi	
117	Asistent i Kryetarit	E9	3.5	Kuvendi	
118	Vozitës i Kryetarit/Nënkryetarit	E10	3.2	Kuvendi	
119	Asistent i nënkryetarit/Grupit Parlamentar	E11	2.8	Kuvendi	
120	Sekretar i Përgjithshëm	E12	7	Kuvendi	
121	Drejtor i Përgjithshëm	E13	6.2	Kuvendi	
122	Drejtor i Drejtorisë	E14	5.2	Kuvendi	
123	Koordinator	E15	4.2	Kuvendi	
124	Këshilltar Juridik	E16	4.2	Kuvendi	
125	Zyrtar Certifikues	E17	4.2	Kuvendi	
126	Zyrtar i lartë Profesional	E18	3.7	Kuvendi	

127	Menaxher i Zyrës së Sekretarit	E19	3.7	Kuvendi	
128	Zyrtar Profesional	E20	3.5	Kuvendi	
129	Asistent Profesional	E21	3.2	Kuvendi	
130	Zyrtar Administrativ	E22	3.1	Kuvendi	
131	Asistent Administrativ	E23	2.8	Kuvendi	
132	Asistent teknik	E24	2.8	Kuvendi	
133	Profesor i rregullt, Profesor emeritus, Këshilltar shkencor	F1	6.3	ushtrimi i pozitave si rektor, prorektor, dekan, prodekan, kompensohen me shtesë funksionale	
134	Profesor i asocuar	F2	5.7	në Universitet	
135	Profesor asistent, bashkëpunëtor shkencor	F3	5.1	në Universitet	
136	Ligjërues në Universitet	F4	4.6		
137	Lektor në Universitet	F5	3.8		
138	Asistent në Universitet	F6	3.75		
139	Hulumtues i pavarur	F7	3.5	hulumtues në institute shkencore	
140	Asistent i ri	F8	3.1	në Universitet	
141	Drejtor i shkollës së mesme				
142	Drejtor i Shkollës Speciale	F9	2.9		
143	Zëvendësdrejtor i shkollës mesme/Speciale	F10	2.7		
144	Drejtor i shkollës fillore	F11	2.7		
147	Mësimdhënës në shkollë të mesme				
148	Mësimdhënës në shkollë speciale	F14	2.6		
145	Zëvendësdrejtor i shkollës fillore	F12	2.5		
146	Drejtor i institucioneve parashkollore	F13	2.5		
149	Mësimdhënës në shkollë të mesme të ulët 6-9	F15	2.45		

150	Mësimdhënës në shkollë të mesme e ulët 1-5	F16	2.3		
151	Pedagog/psikolog			në arsimin para universitar	
152	Sekretar i shkollës	F17	2.3	në shkollat e mesme dhe fillore	
153	Mësimdhënës në institucionet parashkollore	F18	2.25		
154	Bibliotekar	F19	2.1		
155	Edukator	F20	2		
156	Krijuesit dhe përformuesit e kulturës dhe të artit 1	G1	3.4	në institucionet kulturore-artistike	
157	Krijuesit dhe përformuesit e kulturës dhe të artit 2	G2	3	në institucionet kulturore-artistike	
158	Krijuesit dhe përformuesit e kulturës dhe të artit 3	G3	2.6	në institucionet kulturore-artistike	
159	Krijuesit dhe përformuesit e kulturës dhe të artit 4	G4	2.1	në institucionet kulturore-artistike	
160	Krijuesit dhe përformuesit e kulturës dhe të artit 5	G5	1.9	në institucionet kulturore-artistike	
161	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike				
162	Drejtor i Përgjithshëm i SHSKUK-së	H1	6.75		
163	Drejtor i QKUK	H2	6.4		
164	Drejtues në shëndetësi 1	H3	5.3	Shëndetësia e nivelit tretësor	
165	Drejtues në shëndetësi 2	H4	5.2	Shëndetësia e nivelit dytësor	
166	Drejtues në shëndetësi 3	H5	5.1	Shëndetësia e nivelit parësor	
167	Mjek specialist, Stomatolog Specialist			ekspert i mjekësisë ligjore dhe pozita të ngjashme në shëndetësi, në institucionet shëndetësore dhe institucione të tjera ku ushtrohet profesioni përkatës.	
168	Mjek specialist të mjekësisë familjare	H6	5		
169	Mjek në specializim	H7	3.65	në institucionet shëndetësore dhe institucione të tjera ku ushtrohet profesioni përkatës	



170	Mjek i përgjithshëm, Stomatolog			në institucionet shëndetësore dhe institucione të tjera ku ushtrohet profesioni përkatës, Inspektorët shëndetësor	
171	Farmacist	H8	3.5	farmacist i diplomuar, në institucionet shëndetësore dhe institucione të tjera ku ushtrohet profesioni përkatës	
172	Psikolog klinik	H9	3.2		
173	Fizioterapeut/Logoped				
174	Kryeinfermier	H10	2.5	në institucionet shëndetësore	
175	Infermier/mami/teknik mjekësor/Teknik farmacist 1	H11	2.25	Niveli tretësor i shëndetësisë	
176	Infermier/mami/teknik mjekësor/Teknik farmacist 2	H12	2.2	Niveli parësor dhe dytësor i shëndetësisë	
177	Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Policisë	P1	6.5		
178	Ndihmësdrejtor/ Drejtor i departamentit në Polici	P2	6		
179	Kolonel në PK	P3	5		
180	Nënkolonel në PK	P4	4.55		
181	Major në PK	P5	3.9		
182	Kapiten në PK/Inspektor në IPK	P6	3		
183	Toger në PK	P7	2.75		
184	Rreshter në PK	P8	2.4		
185	Polic i Lartë në PK	P9	2.2		
186	Polic	P10	2		
187	Polic i ri	P11	1.9		
188	Kadet policor	P12	1		

189	Ekspert Udhëheqës 1	L1	8	Ekspert që udhëheq një departament funksional në fushën e aviacionit civil dhe Navigimit Ajror	
190	Ekspert Udhëheqës 2	L2	7.5	Ekspert që udhëheq një Divizion funksional në fushën e aviacionit civil dhe Navigimit Ajror	
191	Ekspert 1	L3	7	Ekspert në fushën e aviacionit civil dhe Navigimit Ajror; Ekspert administrojnë sisteme shtetërore me rëndësi strategjike shtetërore	
192	Ekspert 2	L4	5.5	Ekspert në fushën e aviacionit civil dhe Navigimit Ajror; Ekspert administrojnë sisteme shtetërore me rëndësi strategjike shtetërore; Këshilltar juridik 1 në GJK	
193	Ekspert 3	L5	4	Ekspert në fushën e aviacionit civil dhe Navigimit Ajror; Ekspert që administrojnë sisteme shtetërore me rëndësi strategjike shtetërore; Këshilltar juridik 2 në GJK dhe Avokati i Popullit,	
194	Ekspert 4	L6	3.5	Avokat shtetëror, bashkëpunëtor profesional dhe ekspert në gjykatë dhe prokurori	
195	Drejtues 1	L7	5	Zyra kombëtare e auditimit	
196	Auditor 1	L8	4.13	Zyra kombëtare e auditimit	
197	Auditor 2	L9	3.7	Zyra kombëtare e auditimit	
198	Auditor 3	L10	3.26	Zyra kombëtare e auditimit	
199	Auditor 4	L11	2.83	Zyra kombëtare e auditimit	
200	Nëpunës i Kabinetit 1	M1	2.4	në kabinete politike në Presidencë, Zyrë të Kryeministrit (asistent administrativ, vozitës, mbrojtje e afërt, staf mbështetës dhe pozita të ngjashme)	
201	Nëpunës i Kabinetit 2	M2	2.2	në kabinete politike (asistent administrativ, vozitës, mbrojtje e afërt, staf mbështetës dhe pozita të ngjashme)	

202	Nëpunës i Kabinetit 3			në kabinete politike të kryetarëve të komunave (asistent administrativ, vozitës, mbrojtje e afërt, staf mbështetës dhe pozita të ngjashme)	
203	Nëpunës administrativ dhe mbështetës 1	M3	1.8	në të gjitha institucionet e administratës publike (receptionist, vozitës, korrier, kuzhinier, staf mbështetës , sigurimi dhe pozita të ngjashme)	
204	Nëpunës administrativ dhe mbështetës 2	M4	1.6	në të gjitha institucionet e administratës publike (receptionist, vozitës, korrier, staf mbështetës, sigurimi dhe pozita të ngjashme)	
205	Nëpunës administrativ dhe mbështetës 3	M5	1.45	në të gjitha institucionet e administratës publike, mekanik, elektrikist, zdrukthëtar, ujë instalues, farkëtar dhe pozita të ngjashme, stafi në arsimin parauniversitar)	
206	Nëpunës administrativ dhe mbështetës 4	M6	1.35	në të gjitha institucionet e administratës publike (roje, kopshtar, shtëpiak, pastrues, autolarës, rrobalarës dhe pozita të ngjashme)	

Shtojca 2.		Tabela e koeficienteve	
Nr.		Koeficienti	
1		10	
2		9	
3		8.5	
4		8	
5		7.75	
6		7.5	
7		7	
8		6.75	
9		6.65	
10		6.5	
11		6.4	
12		6.25	
13		6.2	
14		6.15	
15		6	
16		5.8	
17		5.7	
18		5.6	
19		5.5	
20		5.4	
21		5.3	
22		5.25	
23		5.2	
24		5.1	
25		5	
26		4.7	
27		4.55	
28		4.5	
29		4.4	
30		4.2	
31		4.13	
32		4.1	
33		4	
34		3.9	
35		3.8	
36		3.7	
37		3.65	
38		3.5	

39	3.4
40	3.26
41	3.2
42	3.1
43	3
44	2.9
45	2.83
46	2.8
47	2.75
48	2.7
49	2.65
50	2.6
51	2.5
52	2.45
53	2.4
54	2.35
55	2.3
56	2.25
57	2.2
58	2.15
59	2.1
60	2
61	1.9
62	1.85
63	1.8
64	1.7
65	1.65
66	1.6
67	1.45
68	1.35
69	1